

Ti konsiderohesh fëmijë nëse je nën moshën 18 vjeçare



FËMIJË MIGRANTË TË PASHOQËRUAR NË BELGJIKË

CILAT JANË TË DREJTAT E TUA?

A graphic illustration of four hands reaching out from the bottom of the page towards the center. The hands are rendered in a soft, painterly style with a color gradient from light green on the left to light red on the right. They are positioned as if offering help or support.

DISA
KËSHILLA
DHE
KONTAKTE
TË DOBISHME
PËR TË TË
NDIHMUAR



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian



TI KE TË DREJTË TË FLASËSH

MIRË TË DIHET

Kujdestari ose **punonjësi social** do të të ndihmojë për të marrë vendime me ty dhe për ty

Profesionistët (policët, avokatët, kujdestarët, punonjësit socialë, gjykatësit, mjekët, etj.) janë njerëz të cilëve mund t'u **besosh**

Ke të drejtë për avokat **falas**

Ke të drejtë për **përkthyes falas**

Organizatat do të të ndihmojnë të kesh qasje në **përkrahje falas** (ushqim, strehim, larje, mjekë, shkollë...) dhe do të sigurojnë që të drejtat e tua të respektohen

Ti **nuk mund të ndëshkohesh** për diçka të paligjshme që ke qenë i detyruar të bësh

PA PATUR FRIKË

Nëse të duhet ndihmë
urgjentisht

në 101

ose 112

MOS
NGURRO
TË KËRKOSH
TË DREJTAT
E TUA





Policia është aty për të të dëgjuar dhe mbrojtur nëse ndjehesh i kërcënuar ose je viktimë, pavarësisht përkatësisë etnike. Ata nuk do të përpiqen të të shkaktojnë asnjë dëm ose të të shfrytëzojnë.

POLICIA

101

OSE

112

OFFICE DES
ÉTRANGERS
VREEMDELINGEN
ZAKEN

(Zyra e Imigracionit)

Chaussée d'Anvers, 59B
1000 Brussels

02/793.80.00

infodesk@ibz.fgov.be

FEDASIL

(Agjencia Federale për
pritjen e azilkërkuesve)

Chaussée d'Anvers, 57
1000 Brussels

02/793.82.40

or 02/213.44.11

info@fedasil.be

Ç'ËSHTË TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE?

Ti ose një nga shokët e tu mund të jeni viktimë e trafikimit pa e kuptuar këtë.

A ke qenë në një situatë ku të është dashur të:

- bësh seks ose kryesh vepra seksuale?
- punosh (për shembull, në shtëpinë e dikujt duke kryer punë shtëpiake apo kujdesur për fëmijë, në fabrikë apo në restorant)?
- lypësh, vjedhësh ose kryesh krime? rritësh, mbash ose shesësh drogë?
- heqësh organet e tua për t'i shitur?
- shlyesh një 'borxh' duke punuar apo dhënë ndonjë shërbim tjetër?

A ke qenë ti/ familja jote nën kërcënim? Nëse i përgjigjesh "po" njërës prej këtyre pyetjeve, mund të jesh viktimë e trafikimit.

Trafikimi njerëzor është krim serioz dhe abuzim i të drejtave të tua. Bisedo me me një profesionist të cilit i beson ose me organizatat e renditura këtu anash nëse je i shqetësuar, që ato të ndihmojnë të ndalet abuzimi, dhe të mbrojnë të rinj të tjerë.



SÛRYA

Liège

Rue Rouveroy, 2
4000 Liège

04/232.40.30

<http://asblsurya.org>



PAG-ASA

Brussels

Rue des Alexiens, 16B
1000 Brussels

02/511.64.64

<http://pag-asa.be>



PAYOKE

Antwerp

Leguit, 4
2000 Antwerpen

03/201.16.90

<http://payoke.be>



- Nëse je nga një shtet tjetër, mund të të duhet leje për të qëndruar në Belgjikë.
- Për të marrë leje qëndrimi, mund të të duhet të shkosh në Zyrën e Imigracionit dhe t'u tregosh historinë tënde. Nëse nuk ke kujdestar ligjor në Belgjikë, Zyra e Imigracionit do të lidhet me Shërbimin e Kujdestarisë që të të caktohet një kujdestar.
- Me kujdestarin tënd mund të diskutosh mbi procedurën më të mirë për të marrë lejeqëndrimin.

Por ki parasysh se nuk të nevojiten dokumente zyrtare për të përfitur nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve.





Në Belgjikë të gjithë fëmijëve pa kujdestar ligjor u caktohet një kujdestar deri kur të mbushin 18 vjeç.

Kujdestari yt do të të ndihmojë që të aplikosh për leje qëndrimi dhe sigurojë që të kesh qasje në shkollë, kujdes mjekësoropsikologjik dhe strehim të përshtatshëm. Ai/ajo është dikush të cilit mund t'i besosh dhe që do të veprojë për ty dhe me ty.

Nëse nuk ndjehesh lirshëm me kujdestarin, mund të flasësh me Shërbimin e Kujdestarisë. Nëse përjeton konflikt me kujdestarin tënd, mund të shkosh vetë ose i shoqëruar te **Gjyqtari i Paqes** për të të caktuar një tjetër kujdestar.

Në Belgjikë, çdo fëmijë ka të drejtë për avokat falas dhe përkthyes falas. Informacionet që ti ndan me ta janë konfidenciale (ata nuk mund t'i përsërisin), përpos nëse është e nevojshme për të të mbrojtur ty.



MAISONS DE
JUSTICE
JUSTITIEHUIZEN
(SHTËPITË E DREJTËSISË)

www.maisonsdejustice.be

www.justitiehuisen.be

BUREAU D'AIDE
JURIDIQUE

Brussels/Wallonia

<http://avocats.be/fr/bureaux-daide-juridique-baj>

SERVICE
DES TUTELLES
DIENST VOOGDIJ

(SHËRBIMI I
KUJDESTARISË)
Boulevard de Waterloo, 115
1000 Brussels

078/15.43.24

tutelles@just.fgov.be

JUGE DE PAIX
VREDERECHTER
(GJYKATËSI I PAQES)

<http://tribunaux-rechtbanken.be>

Në organizatat më poshtë,
do të takosh punonjës socialë dhe
fëmijë të tjerë. Punonjësit socialë
do të mundësojnë që ti të jesh i sigurt
dhe të kesh qasje në ushqim, strehim,
larje, shkollë si dhe të kesh profesionistë të
besueshëm (p.sh. kujdestarë, avokatë).

SERVICES D'AIDE EN
MILIEU OUVERT
(AMO)

Brussels

<http://amobxl.be>

Wallonia

[http://pro.guidesocial.be/
associations/services-
d-aide-milieu-ouvert-
amo-1580.html](http://pro.guidesocial.be/associations/services-d-aide-milieu-ouvert-amo-1580.html)

CENTRA ALGEMEEN
WELZIJNSWERK
(CAW)


Flanders

<http://caw.be/zoek-je-hulp>

MBI PUNONJËSIT SOCIALË



Si fëmijë ti ke të drejtë për **kujdes mjekësor falas** dhe **arsim falas**. Shkolla në Belgjikë është e detyrueshme për këdo nën moshën 18 vjeçare. Kujdestari yt do të sigurojë që të kesh qasje në shërbim mjekësor dhe arsim të përshtatshëm.



Meqë je fëmijë, të jepet qasje në mbrojtje specifike. Autoritetet mund të kërkojnë që të kontrollojnë moshën tënde për t'u siguruar që je fëmijë. Prandaj, është më mirë të tregosh moshën e vërtetë.

Ti ke të drejtën ta kontestosh rezultatin e testit të moshës. Pyet kujdestarin tënd ose dikë të cilit i beson.

Ti mund të refuzosh ta bësh testin e moshës, por ka mundësi të trajtohesh si i rritur.

NËSE TË DUHET KËSHILLIM APO ASISTENCË SOCIALE

Nganjëherë gjërat ndodhin ndryshe nga ç'i pret. Ka plot organizata që mund të të ndihmojnë t'i zgjidhësh këto probleme.



PLATE-FORME
MINEURS EN EXIL
PLATFORM
KINDEREN OP
DE VLUCHT

02/210.94.91

<http://mineursenexil.be>



SERVICE DROIT
DES JEUNES
(SDJ)

Brussels/Wallonia

<http://www.sdj.be>



JONGEREN ADVIES
CENTRUM
(JAC)

Brussels/Flanders

<http://jac.be>



NËSE JE NË RREZIK APO KE NEVOJË PËR MBROJTJE

INFO-KONTAKTE



SERVICE D'AIDE À LA JEUNESSE (SAJ)

Brussels/Wallonia

<http://www.aidealajeunesse.cfwb.be/index.php?id=359>


JONGEREN EN WELZIJN

Brussels/Flanders

<http://www.wvg.vlaanderen.be/jongerenwelzijn/jeugdhulp/intersectorale-toegangspoort/>







Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e ECPAT Francë dhe partnerëve të tij në projektin ReACT: ECPAT Belgjikë, ECPAT Gjermani, ECPAT Holandë dhe ECPAT MB, dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

